



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:077825

Datë: 30.10.2020

Numri i dokumentit: 01232814

P.nr.109/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari Sulltan Dobraj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër te pandehurit Z.Ç. nga fsh. K-Deçan, për shkak te veprës penale cenimi i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1. të KPK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Peja PP/II.574/2020 te dt.29.06,2020, ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me dt14.10.2020, me pjesëmarrjen e prokurorit te shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit dhe mbrojtësit te tij Av. Haxhi Beqiraj, po të njëjtën dit mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**30.10.2020** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Z.Ç., i lindur me dt..... ne fsh. K-Deçan, me banim ne Rr. "....." nr. në fsh. k-Deçan, i biri i T. dhe nënës Gj. e vajzërisë H., me nr. tel:, shqiptar, shtetas i Kosovës, **gjendet ne liri.**

ESHTË FAJTOR

Për arsye se:

Nga data e pa njohur e gjerë me dt.17.02.2018 në shtëpinë e të dëmtuarës N.Ç. ne rrugën "....." nr. 18 ne fshatin K-Deçan, pa autorizim dhe në mënyrë të kundërligjshme hynë ne shtëpinë ose objektin e mbyllur të personit tjetër ne atë mënyrë që i pandehuri kishte shkuar ne shtëpinë e të dëmtuarës, në njërin nga dhomat e katit të parë të asaj shtëpie e cila ishte e pa banuar kishte modifikuar dhe mbyllur me blloka te betonit dritaren dhe derën e hyrjes ku të njëjtës i është lënë vetëm një hyrje përmes katit të dytë.

- **me çka ka kryer veprë penale cenimi i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1. të KPK-ës**

Andaj gjykata, bazë te neneve 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 55, 197 par. 1 të KPK- se, dhe nenet 365, 453, 463 të KPPK-së te akuzuarin e :

G J Y K O N

ME DËNIM NE KUSHT ME URDHER PER MBIKEQYRJEN NGA SHERBIMI SPROVUES

- I. I shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditë, me kusht**, të cilin dënim fare **nuk do ta mbaj**, nëse në afat **prej 1(një) viti** nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
- II. Dënimi me kusht do te mbikëqyret nga shërbimi sprovues.
- III. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht nëse i dënuari gjate kohës se verifikimit kryen një apo me shumë vepra penale.
- IV. **URDHEROHET**, i pandehuri qe te mbaj kontaktin me shërbimin sprovues, dhe i njëjti njoftohet, se ne rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund te revokoj dënimin me kusht
- V. E dëmtuara N.Ç. Rr. “..... “ K- Deçan për realizimin e kërkesës pasurore juridike urdhërohet ne kontekst te rregullt civil .
- VI. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II.nr.574/2020 te dt.29,06,2020**, ka akuzuar Z.Ç. nga fshati K-Deçan , për veprën penale lëndimi cenimi i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1. të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti te shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me 14.10.2020 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar konform nenit 248 te KPPK-ës.

Prokurori ka deklaruar se: Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë e ky pranim fajësie mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lëndës unë ne tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj gjykatës i propozoi qe i njëjti te shpallet dhe te dënohet sipas ligjit, si rrethana lehtësuese te merret pranimi i fajësisë.

Av. Haxhi Beçiraj mbrojtës i të pandehurit ka deklaruar dhe i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese gjykata të merr pranimin e fajësisë dhe gjendjen shëndetësore të të pandehurit.

I pandehuri deklaroj se: e mbështet deklarin e mbrojtësit të tij dhe premtion që në te ardhmen nuk do te merret me veprime te tilla dhe shton se te gjitha këto veprime kanë qenë në te kaluarën dhe nuk merret mo me kësi veprimesh.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Nga data e pa njohur e gjerë me dt.17.02.2018 në shtëpinë e të dëmtuarës

N.Ç. ne rrugën “.....” nr. ne fshatin K-Deçan, pa autorizim dhe në mënyrë të kundërligjshme hynë ne shtëpinë ose objektin e mbyllur të personit tjetër ne atë mënyrë që i pandehuri kishte shkuar ne shtëpinë e të dëmtuarës, në njërin nga dhomat e katit të parë të asaj shtëpie e cila ishte e pa banuar kishte modifikuar dhe mbyllur me blloka te betonit dritaren dhe derën e hyrjes ku të njëjtës i është lënë vetëm një hyrje përmes katit të dytë.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprën penale te lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do te këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barre, i cili pranim fajësie mbështet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne kuptim te nenit 257 te KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë konform nenit 248 te KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bere ne mënyre vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te pandehurit janë formuar te gjitha elementet e figurës se veprës se veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-ës, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar e ka dëshiruar, për veprimet e tilla te cilat përmbushen elementet e veprës penale te lartcekur, është përgjegjës dhe i përgjegjshëm, andaj gjykata ka vendosur dhe te pandehurin e shpall fajtor për këtë vepër penale, i ka shqiptuar dënimin me kusht me burgim në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallen e rrezikshmërisë shoqërore, dhe ne këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit qe parashihet ne nenin 38 te KPRK-ës, si mase për parandalimin e te pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave te tjerë kryes potencial te veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 70 të KPK-ës me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, te cilat mund te ndikojnë ne lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj te pandehurit.

Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pastaj kërkim falja nga ana e te pandehurit, gjendja shëndetësore e tij, ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ne baze te nenit 58 te KPK ka urdhëruar te pandehurin që të mbaj kontaktin me shërbimin sprovues, dhe i njëjti njoftohet, se në rast se e shkëputë kontaktin me shërbimin sprovues, gjykata mund te revokoj dënimin me kusht.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK-së te dëmtuarin N.Ç. nga Deçan Rr. “.....”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar ne kontest te rregullt civil.

Gjykata në bazë te nenit 453 të KPPK-së te pandehurin e liron nga shpenzimet e procedurës penale për shkak te gjendjes se dobët ekonomike sepse gjykata ka marr parasysh faktin se i pandehuri është i pa punë.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.109/2020 të dt.30.10.2020**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sultan Dobraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykates Themelore Peje dega ne Deçan.